

**AKT THEMELIMI I
SHOQËRISË AKSIONARE ME OFERTË PRIVATE
HAPPY PAY SH.A.**

Sot në Tiranë, më 19.05.2025, u miratua ky Akt Themelimi, si më poshtë:

- Shoqëria **Balfin - Balkan Finance Investment Group SH.P.K.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB") me numër regjistrimi (NUIS) K72223031K, me seli të regjistruar në Njësine Bashkiake Nr.2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndërtesa Nr.12, Kat i 11, Zyra nr.1100, Kodi Postar 1010, Tiranë, Shqipëri ("**Aksionari i Vetëm**").

I. Themelimi

- 1.1 Aksionari i Vetëm miraton themelimin e Shoqërisë Aksionare Shqiptare me ofertë private **Happy Pay SH.A.** (këtu e më tej referuar si "**Shoqëria**"), në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i përditësuar (këtu e më tej referuar si "**Ligji për Shoqëritë Tregtare**"), Ligji Nr. 9662, datë 18.12.2006, "*Për bankat në Republikën e Shqipërisë*" (këtu e më tej referuar si "**Ligji për Bankat**"), Ligji Nr. 55/2020, datë 30.04.2020, "*Për shërbimet e pagesave*" (këtu e më tej referuar si "**Ligji për Shërbimet e Pagesave**"), dhe Vendimi Nr. 59, datë 24.11.2021, "*Për miratimin e rregullores "Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave"* (këtu e më tej referuar si "**Rregullorja e Licencimit**").
- 1.2 Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: Rr. Reshit Çollaku, Pallati Shallvareve, Zona Kadastrale 8380, Numër Pasurie 7/135+ 6 - 84, Volumi 9, Faqe 16, Tiranë, Shqipëri.
- 1.3 Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pacaktuar.

II. Objekti

- 2.1 Qëllimi i Shoqërisë është të kryejë aktivitete financiare për paranë elektronike dhe pagesa për një kohëzgjatje të pacaktuar.
- 2.2 Shoqëria, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë dhe kriteret e përcaktuara nga Ligji për Shërbimet e Pagesave, mund të kryejë aktivitetet e mëposhtme:
 - (1) Shërbimet e pagesave;
 - (2) Transferta e parave;
 - (3) Emetimi i parasë elektronike;
 - (4) Shërbimet që mundësojnë depozitimin e parave fizike në një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese;
 - (5) Shërbimet që mundësojnë tërheqjen e parave fizike nga një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese;
 - (6) Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagesash të çelur pranë ofruesit të shërbimit të pagesave të përdoruesit ose pranë një ofruesi tjetër të shërbimit të pagesave:
 - a) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë dhe debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;
 - b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme;
 - c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.
 - (7) Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, ku fondet janë të mbuluara nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave;

- a) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë dhe debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;
 - b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme;
 - c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.
- (8) Emetimi i një instrumenti pagese dhe/ose pranimi i transaksioneve të pagesave;
- (9) Dërgesat e parave;
- (10) Shërbimi i inicimit të pagesës;
- (11) Shërbimi i informimit të llogarisë.
- 2.2 Në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe licencën(at) e lëshuara nga Banka e Shqipërisë, për të arritur qëllimet e parashikuara në pikën 2.1 të këtij Neni, Shoqëria mund të:
- a. kryejë çdo aktivitet tjetër dhe të ofrojë shërbime të tjera financiare, me kusht që një aktivitet i tillë të licencohet dhe lejohet nga autoriteti përkatës;
 - b. kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i nevojshëm për të arritur qëllimin e veprimtarisë së Shoqërisë.
- 2.3 Shoqëria do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse në Republikën e Shqipërisë dhe standardet më të mira etike.

III. Statuti

- 3.1 Aksionari i Vetëm deklaron zbatimin e Statutit të Shoqërisë.

IV. Kapitali

- 4.1 Kapitali aksionar i Shoqërisë, i nënshkruar dhe i shlyer plotësisht, është ALL 45,000,000.00 (dyzet e pesë milionë lekë), i ndarë në 45,000 (dyzet e pesë mijë) aksione me vlerë nominale ALL 1,000.00 (një mijë lekë).
- 4.2 Kapitali aksionar i Shoqërisë është i zotëruar plotësisht nga Aksionari i Vetëm i Shoqërisë:
- Shoqëria **Balfin - Balkan Finance Investment Group SH.P.K.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në QKB me numër regjistrimi (NUIS) K72223031K, me seli të regjistruar në Njësinë Bashkiake Nr.2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndërtesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1100, Kodi Postar 1010, Tiranë, Shqipëri.

V. Këshilli i Administrimit

- 5.1 Këshilli i Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të emëruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me Statutin, ku të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit janë të pavarur (joekzekutivë) dhe të ndryshëm nga Administratori i Shoqërisë.
- 5.2 Afati i emërimit i anëtarëve të Këshillit të Administrimit është 3 (tre) vjet, me mundësi rizgjedhjeje.
- 5.3 Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit janë emëruar, si më poshtë:
- **Z. Dritan Mustafa**, shtetas shqiptar, lindur më 04.07.1973 në Durrës, Shqipëri, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. BR3977439 dhe nr. personal H30704133K, duke vepruar në cilësinë e Drejtorit Joekzekutiv dhe Kryetarit të Këshillit të Administrimit; dhe

- **Z. Leons Tuda**, shtetas shqiptar, lindur më 07.08.1992 në Shijak, Shqipëri, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. BE5028529 dhe nr. personal J20807059Q, duke vepruar në cilësinë e Drejtorit Joekzekutiv; dhe
 - **Znj. Matilda Shehu**, shtetase shqiptare, lindur më 27.04.1973 në Korçë, Shqipëri, banuese në Tiranë, mbajtëse e pasaportës me nr. BA9248482 dhe nr. personal H35427169L, duke vepruar në cilësinë e Drejtorit Joekzekutiv.
- 5.4 Në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë shpërblimin për anëtarët e Këshillit të Administrimit.

VI. Administratori

- 6.1 Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili është person fizik, i emëruar nga Këshilli i Administrimit.
- 6.2 Administratori emërohet për një mandat 3 (tre) vjeçar dhe ka të drejtë rizgjedhjeje.
- 6.3 Administratori i Shoqërisë mund të caktojë një përfaqësues "*ab negotia*" për kryerjen e detyrave apo kategorive specifike të detyrave, brenda kufijve të tagrave që i janë dhënë sipas Statutit të Shoqërisë.
- 6.4 Administratori i parë i Shoqërisë emërohet si më poshtë::
- **Znj. Daniela Malaj**, shtetase shqiptare, lindur më 17.10.1986 në Bllaçë, Shqipëri, banuese në Tiranë, mbajtëse e pasaportës me nr. BF4394684 dhe nr. personal I66017062I.

VII. Auditorët

- 7.1 Auditimi i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga kontabilistë të autorizuar, të emëruar për 1 (një) vit fiskal nga Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me Ligjin për Shërbimet e Pagesave.

Ky Akt i Themelimit është bërë në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën angleze me efekt juridik të barabartë. Akti i Themelimit është në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Për Aksionarin e Vetëm të Shoqërisë
Balfin - Balkan Finance Investment Group SH.P.K.

përfaqësuar nga

Edlira Muka



Administrator

